



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25.2.2025

Nr: 179

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “LËVIZJA PËR ZHVILLIM KOMBËTAR”, ME BASHKËKRYETAR Z. DASHAMIR SHEHU/ Z. EQEREM SPAHIU, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

Sot më datë 25.2.2025, në seancë publike mora në shqyrtim kërkesën nr. 1269 Prot., datë 24.02.2025, me:

Kërkues: Partia politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, me bashkëkryetar Z. Dashamir Shehu dhe Z. Eqerem Spahiu.

Objekti: Regjistrimi i partisë politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” si subjekt zgjedhor për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

Baza ligjore: Neni 64 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399 datë 5.12.2024 ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend.

Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, me bashkëkryetar, Z. Dashamir Shehu dhe Z. Eqerem Spahiu, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 24.02.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, me iniale “LZHK”, me bashkëkryetar Z.

Data: 25.2.2025 Nr: 179
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” me bashkëkryetar z. Dashamir Shehu dhe z. Eqerem Spahiu, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”

Dashamir Shehu dhe Z. Eqerem Spahiu, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.

- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02)
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03)

Nga dokumentacioni si më sipër dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” me shkronja nistore “LZHK”, me adresë: Rruga "Andon Zako Çajupi", Tiranë;
- b) Bashkëkryetar të partisë janë Z. Dashamir Shehu, dhe Z. Eqerem Spahiu, me adresë: Rruga "Ali Visha", Pll.1, Ap.30, Tiranë.
- c) Financieri i partisë është Zj. Suzana Gina, me adresë: “Rruga e Barrikadave”, Pll.Nr.4, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjes për komunikim me KQZ-në është Z. Rizaldo Vrenosi dhe Z.Fabian Topollari, me adresë: Rruga "Sofokli Maliqari", Nd.7, Korçë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.01.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 Maj 2025.

V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, me bashkëkryetar Z. Dashamir Shehu, dhe Z. Eqerem Spahiu, me shkronjat nistore “LZHK”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI